

H Y R J E

Nga pikëpamja e burimeve njerëzore, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, sipas organikës së miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për vitin 2021 ka patur një organikë prej **44** punonjësish nga të cilët: **19** prokurorë, **9** oficerë të policisë gjyqësore, si dhe **16** punonjës administrate.

Përgjatë vitit 2021 ka patur lëvizje të prokurorëve caktime të përkohshme, leje, shkarkim nga veting, transferime duke bere qe pergjate vitit 2021 te ushtronin detyren **12** prokurore.

Nuk ka qene e plotesuar organika per gjate gjithe vitit 2021 dhe per oficeret pasi shtesa është bërë në muajin Dhjetor (nga **14** O.P.Gj. kanë qenë efektiv vetëm **9**)

Sipas organizimit të brendshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë kanë funksionuar për gjatë vitit 2021, **3** (tre) seksione:

- Seksioni i Veprave Penale të Tjera me **9** Prokurorë (**1** drejtues seksioni dhe **8** prokurorë).
- Seksioni i të Miturve dhe Ekzekutimit të Vendimeve Penale, me **3** prokurorë (**1** drejtues seksioni dhe **2** prokurorë).
- Seksioni i Posaçëm, i krijuar sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm. Më datë 27.07.2020. Seksioni është shndërruar në Seksionin për Hetimin e Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve Pasurore, në zbatim të Udhëzimit Nr.10 datë 17.07.2020. të Prokurorit të Përgjithshëm, në përbërje të së cilit janë **3** prokurorë , (**1** drejtues seksioni dhe **2** prokurorë).

Objektivat prioritarë.

Nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë përparësi dhe vëmëndje të veçanë i është kushtuar realizimit të objektivave përcaktuar nga analiza e bërë ne vitin **2020** për vitin **2021**, si dhe problematikave kryesore te qytetit te Vlores sikurse jane: Fallsifikimi i dokumentave per perfitimin e padrejte te siperfaqes se tokes, Ndertimet pa leje sidomos ne zonen e bregdetit, Kultivimi i bimeve narkotike etj .

Rritja e rolit aktiv e prokurorit dhe hetimet proaktive.

Në lidhje me hetimet proaktive, per vitin **2021** kemi regjistruar **12** procedime penale te iniciuara nga prokuroret e Seksionit të Posaçëm, per veprat penale qe lidhen me fallsifikimin e pronave.

Rezulton se vitin 2021 jane regjistruar :

- ✓ **73** procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal
- ✓ **188** procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal;
- ✓ **7** procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 298 të Kodit Penal;
- ✓ **6** procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal;
- ✓ **11** procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal;
- ✓ **4** procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal;
- ✓ **2** procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

Në disa prej hetimeve të këtyre procedimeve penale, rezulton se vëzhgimi dhe filmimi në ambiente publike i autorizuar nga prokurori në disa raste nuk ka qenë i suksesshëm, për shkak të mungesës së strukturave përkatëse në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë dhe burimeve njerëzore.

Në lidhje me veprat e mësipërme, rezulton se prokurorët përgjithësisht kanë kërkuar dënime të ashpra, si dhe kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, ndaj personave të proceduar për kryerjen e këtyre veprave penale

Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë për vitin 2021.

Volumi i punës.

Gjatë vitit 2021, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë trajtuar gjithsej **4853** materiale, nga të cilat janë referuar **3358** (kallëzime/referime) për vepra të ndryshme penale dhe **1428** të mbartura nga viti 2020.

Nga materialet/referimet e mësipërme për vitin 2021 janë rregjistruar gjithsej **2142** procedime penale dhe janë mbartur për vitin 2022, **1616** procedime penale.

Për gjatë vitit 2021 janë regjistruar **59** procedime penale mbi bazën e vendimit të ndarjes së çështjes.

<i>VITI</i>	<i>TOTALI</i>	<i>Materiale te rregjistruar</i>	<i>Procedime të mbartura nga viti paraardhës</i>	<i>Procedime të rregjistruara</i>	<i>Të përfunduara</i>	<i>Mbartur për vitin pasardhës</i>	<i>Seksioni i të Miturve</i>
<i>2021</i>	4853	<i>3358+67¹</i>	<i>1428</i>	<i>2142</i>	1954	1616	27
<i>2020</i>	4355	<i>3137</i>	<i>1151</i>	<i>2104</i>	1827	1428	33

Sipas të dhënave të mesipërme, krahasuar me vitin paraardhës rezulton se në vitin 2021 ka një shtim të numrit të materialeve të trajtuara (**518** materiale me tepër) si dhe procedime të përfunduara (**127** procedime me shume)

Referuar organikes për vitin 2021, numri i prokuroreve është miratuar për **19** prokurore por në fakt kanë ushtruar funksionin **12** prokurore, si rrjedhojë prokuroret kanë marrë me tepër ngarkesë pune pasi dosjet janë rishortuar midis prokuroreve aktual duke patur një volum pune me një mesatare më të lartë numrit të çështjeve të trajtuara prej tyre.

¹ Materiale që nuk kanë marrë numer (në verifikim mbartur nga 2020)

Me konkretisht në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 nga materialet e trajtuara rezulton si me poshte :

- 1. Mosfilluara jane 1194 kallëzime penale kundrejt 1030 per vitin 2020** (veprat penale që ndiqen me ankim ose drejtëpërdrejtë me ankim në gjykatë sipas nenit 59 të Kodit të Proçedurës Penale)
- 2. Gjykuar 651 proçedime penale me 742 te pandehur kundrejt 540 me 618 te pandehur per vitin 2020** (për veprën penale parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ndjekur nga veprat penale parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, vepra penale parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, veprat penale parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, vepra penale parashikuar nga neni 283,284 i Kodit Penal, vepra penale parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, veprat penale parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, si dhe vepra penale parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.)
- 3. Pushuar 484 procedime penale kundrejt 528 per vitin 2020** (kryesisht i zënë proçedimet penale të regjistruara për veprën penale të “Plagosja e lehtë me dashje”, “Falsifikimit të dokumentave”, “Ndërtim i paligjshëm”, “Shpërdorimit të detyrës”, “Kanosjes” dhe “Shkatërrimit të pronës”, të parashikuara nga nenet 89, 186, 199/a, 248, 84 dhe 150 të Kodit Penal.)
- 4. Pezulluar 779 procedime penale kundrejt 720 per vitin 2020** (këto vepra penale i referohen kryesisht vjedhjeve të banesave, aparateve celularëve (shtim ky në numër gjatë sezonit turistik), ku identifikimi i autorëve është i vështirë për shkak të cilësisë në veprimet e para hetimore, por dhe lëvizjes së autorëve të mundshëm gjatë sezonit turistik)
- 5. Transferuara 40 procedime penale kundrejt 39 per vitin 2020** (vepra qe lidhen me mungesene kompetencen territoriale dhe lendore).

Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve

Gjatë vitit **2021**, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë përfunduar gjykimet për **555** çështje penale me **637** të pandehur.

Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë gjatë vitit 2021, është kërkuar dënimi i të pandehurve me gjobë në **88** raste, pushim çështje në **3** raste, për **1** rast është kërkuar dënim në minimum, ndërsa në rastet e tjera është kërkuar dënim me burgim.

Në raport me procedimet e përfunduara për vitin **2021**, rezulton se rreth **34%** e këtyre procedimeve penale kanë përfunduar me kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq.

Për gjatë vitit **2021** rezulton se për **13** procedime penale dhe **18** të pandehur është dhënë vendim pafajësie. Ne te gjitha rastet e pafajësive eshte ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore.

Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit pasuror.

Me urdhërin Nr.2 datë 27.07.2020. të Drejtuesit të Prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është krijuar Seksioni për Hetimin e Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve Pasurore, në zbatim të Udhëzimit nr.10 datë 17.07.2020. të Prokurorit të Përgjithshëm, ku në përbërje të seksionit janë atashuar 3 prokurorë.

Në këtë drejtim në zbatim të Memorandimit të Bashkëpunimit me nr.1079 prot. datë 15.07.2020. të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Brendshme, janë vendosur kontakte me palët përkatëse në nivel lokal, ku ka vijuar një bashkëpunim i mirë me strukturat përkatëse të policisë gjyqësore pranë D.V.P.Vlorë.

Nga ana tjetër vlen të theksohet se prej institucioneve në varësi të Ministrisë së Financave e konkretisht Drejtorisë së Tatimeve dhe Drejtorisë së Doganave, nuk ka patur asnjë rast të referimit të materialeve, që prej nënshkrimit të këtij memorandumi.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë zbatuar parashikimet e Memorandimit të Bashkëpunimit.

Në lidhje me këtë grup veprash penale gjatë vitit 2021 rezulton se janë regjistruar **35** (tridhjetë e pesë) procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Nga këto procedime penale, **12** (dymbëdhjetë) procedime penal janë pushuar, **2** (dy) procedime janë pezulluar (pesë) dhe **1** (një) procedim është dërguar për gjykim, ndërsa procedimet e tjera ndodhen në fazën e hetimeve paraprake.

Për vitin **2021** janë rregjistruar **21** procedime pasurore,

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, rezulton se në hetimet paraprake konstatohet si pengesë pamundësia për të lidhur pasurinë e identifikuar me veprimtarinë apo veprën penale të kryer nga personi posedues i pasurisë. Në shumë raste materialet hetimore referohen vetëm mbi bazën e identifikimit të pasurisë, por pa specifikuar veprën penale mëmë apo veprimtarinë kriminale nga të cilat mund të jenë realizuar këto të ardhura. Në mungesë të këtyre të dhënave është bërë e pamundur edhe paraqitja e kërkesës për caktimin e masës së sekuestros preventive në momentin e regjistrimit të procedimit penal.

Për vitin 2021, në funksion të **5** procedimeve penale dhe mbi bazën e kërkesës së prokurorit për veprat penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal është caktuar masa e sigurimit pasuror të sekuestros preventive për **39** pasuri të paluajtshme dhe luajtshme si : apartamente banimi , toka , garazhe , makina, llogari bankare.

Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror.

Gjatë vitit **2021**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë referuar në funksion të procedimeve penale të rregjistruara **382** raste të personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar. Nga këtu për **2** raste është urdhëruar lirimi i menjëhershëm dhe janë dërguar 380 kërkesa për vlerësim në Gjykata, nga këto Gjykata në **7** raste i ka vlerësuar të paligjshme.

Për personat e arrestuar dhe ndaluar, janë dërguar aktet në gjykatë për vleftësim arresti në flagrancë/ndalimi dhe është kërkuar në **265** raste caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, në **17** raste është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” në mungesë, në **8** raste është kërkuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi), në 2 raste është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” me afat, si dhe në **87** raste është kërkuar masa e sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore. Në lidhje me kërkesat e mësipërme rezulton se nga gjykata është pranuar kërkesa dhe është caktuar masa e sigurimit arrest në burg për **207** raste, dhe në të gjitha rastet kur është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg në mungesë, gjykata e ka pranuar kërkesën e prokurorit. Ndërsa në **22** raste është caktuar masa e sigurimit arrest në shtëpi, për **5** raste është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” me afat dhe në **125** raste është caktuar masa e sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, dhe **4** rast me garaci pasurore.

Të miturit, veprat penale të dhunës në familje dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktima.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, funksionon Seksioni për të Miturit, Ekzekutimet e Vendimeve Penale dhe Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë, i cili përbëhet nga **3** prokurorë dhe **1** oficer i policisë gjyqësore, ku është ushtruar ndjekja penale për vepra penale të përfshira në juridiksionin (territorin) e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky seksion ka trajtuar gjithsej **49** çështje penale të referuara. Nga këto **22** janë mosfilluar sipas institutit të shmangies të ndiekjes penale dhe **27** çështje janë regjistruar procedime penale. Nga procedimet e regjistruara **16** prej tyre janë pushuar (shmangie) nga ndjekja penale dhe **6** prej tyre janë dërguar në gjykim.

Nga ana e organit të akuzës është mbajtur parasysh në caktimin e dënimit për të miturit të gjitha konventat, ligjet, udhëzimet, në lidhje me kujdesin që duhet të tregohet ndaj tyre. Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar caktimit të masave të sigurimit.

Në lidhje me zbatimin e kuadrit ligjor lidhur me drejtësinë për të miturit, përgjatë vitit 2021, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në rastet kur të miturit kanë marrë cilësinë e të pandehurit/ personit nën hetim janë aplikuar masa sigurimi të përshtatshme duke treguar kujdes, në mënyrë që të mos ndërpritet procesi edukativ dhe ri-integrimi i tyre në shoqëri, ndërsa në lidhje me masat e dënimit, janë shtuar rastet e dënimeve alternative apo është vlerësuar me kujdes çdo material që në fazën e referimit të tij. Po kështu janë shtuar rastet e dënimeve alternative, rastet e përjashtimit të të miturit në konflikt me ligjin nga përgjegjësia penale, si dhe është vlerësuar me kujdes çdo material që në fazën e referimit të tij.

Rezulton se, vetëm në raste të veçanta është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg” ndaj të miturve që janë proceduar penalisht për vepra të rënda, dhe përjashtimisht në disa raste për vjedhje të kryera në bashkëpunim e më shumë se një herë, nga subjekte përsëritës dhe problematikë për komunitetin

Gjithashtu, rezulton se në **22** referime të cilat janë mosfilluar dhe **13** procedime penale janë marrë masa alternative duke shmangur të miturin në konflikt me ligjin nga përgjegjësia.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë nuk janë evidentuar procedime penale të regjistruara për vepra penale të kryera, të cilat kanë patur motive të urrejtjes, dhe as procedime penale të pornografisë me fëmijë.

Në fushën e krimeve me natyrë seksuale janë referuar **6** materiale për veprën penale të “Ngacmimit seksual” parashikuar nga neni 108/a i K.P. ka pasur **5** referime, ku **4** çështje janë mosfilluar, **1** është regjistruar procedim penal.

Po kështu janë referuar **26** çështje nga të cilat **9** janë regjistruar procedime penale për veprën penale e parashikuar nga neni 121/a i K.P.

Veprat penale ne fushën e zgjedhjeve.

Për gjatë vitit 2021 nuk rezulton të jenë regjistruar procedime penale në lidhje me zbatimin e ligjit Nr. 138/2015.

Persa i perket veprave penale ne fushen zgjedhjeve, pergjate vitit 2021 jane regjistruar **8** kallezime penale nga te cilat **3** jane mosfilluar dhe **5** jane regjistruar si procedime penale

Nga **5** procedimet penale të regjistruara, për **1** procedim penal është bërë kërkesë për pushim ne gjykate, **1** procedim me 1 të pandehur është dërguar per gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka pranuar kërkesën e Prokurorisë dhe e ka shpalluar fajtor personin e akuzuar.

3 (tre) procedime të tjera janë mbartur për vitin pasardhes.

PROBLEMATIKA

Mbi zbatimin e sistemit CAMS.

Në sistemin CAMS nga punonjësi i zyrës së regjistrimit hidhen te gjitha të dhënat që pasqyrohen në regjistër që në momentin e regjistrimit të materialit kallëzues.

Nga ky rregull bënë përjashtim vetëm rastet që kanë të bëjnë me ndalimet në flagrancë, sekueotrot apo dhe raste të tjera për të cilat nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit veprohet me iniciative, apo komunikohet me Prokurorin e sipas listës së gadishmërisë e cila përpilohet nga Drejtuesi në fillim te çdo muaji. Gjatë vitit 2021 janë konstatuar problematika në funksionimin e sistemit CAMS, të raportuara edhe ne zyren e teknologjisë së informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme, në veçanti në raste kur është bërë zëvendësimi i Prokurorit, proces i cili nuk ofrohet nga sistemi ne ri-shortim automatik, duke bërë që të operohet me hedhje të shortit manual apo dhe ne raste të tjera është kërkuar që të mos vazhdohet me pasqyrimin e të dhënave në sistem për një periudhë të caktuar kohore, si pasoje e azhornimit te programit ne serverat e Prokurorise se Pergjithshme.

Kapacitetet infrastrukturore dhe siguria.

Ne lidhje me kapacitetet infrastrukturore rezulton se, godina në të cilën ushtron aktivitetin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është e amortizuar, e pamjaftueshme përsa i përket zyrave, pasi në shumë zyra ushtrojnë funksionin e tyre 2 dhe 3 punonjës të administratës, prokuror ose OPGJ.

Problematika e mësipërme, e cila është kaluar me shumë vështirësi gjatë viteve 2020-2021, ka krijuar një situatë të tillë ku për vitin 2022 nuk kemi asnjë hapësirë bosh për ta përshtatur për ambiente arkive, dhe ndodhemi në kushtet e emergjencës dhe pamundësisë për vijueshmëri normale të punës.

Në këto kushte, dosjet e përfunduara mbahen në zyrë nga çdo Prokuror, situatë e cila përveç mos mjaftueshmërisë së zyrës për ushtrimin normal dhe efikas në ushtrimin e detyrës, ka sjellë dhe vështirësi në administrimin e tyre (dosjeve) të cilat kërkohen të administrohen në kuadër të procedimeve të tjera, apo kur kërkohen kopje të akteve nga personat/institucionet e interesuara.

Se fundmi kemi nevojë/emergjence për një automjet për tu përdorur në veprimtarinë tonë të përditshme, për nevojat brendshme të institucionit tonë si : marrja e mjeteve materiale në Prokurorinë e Përgjithshme , provave materiale, kqyrje vendi ngjarje etj, problem ky i cili me angazhimin e Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme mund të zgjidhet së shpejti

Bashkëpunimi ndërinstytucional.

Prokuroria Prane Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë gjatë vitit **2021** ka patur marrëdhënie korrekte në nivel institucional me Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, qoftë duke garantuar pjesëmarrjen e prokurorëve në seancat gjyqësore ashtu dhe për çdo problematike që mund të lindë gjatë proceseve gjyqësore.

Gjatë vitit 2021 është synuar rritja e bashkëpunimit sidomos me strukturat e policisë së shtetit, si një nga bashkëpunuesit kryesor për përmirësimin e punës dhe arritjen e suksesit në hetimin e çështjeve penale si dhe evidentimin e situatave problematike. Ky bashkëpunim ndërinstytucional ka qënë produktiv dhe mbështetës për kërkesat e policisë, por edhe për delegimet e veprimeve hetimore dhe kryerjen e detyrave nga ana e tyre. Ka qënë një bashkëpunim i fokusuar jo vetëm në nivel drejtimi por një bashkëpunim edhe në nivelin bazë. Ka pasur komunikim të vazhdueshëm përse i përket ngjarjeve të rënda dhe me ndikim në opinion publik sikurse dhe nga ana e prokurorisë në çdo rast nuk ka munguar prezenca e prokurorit në vendngjarje.

Bashkëpunim specifik dhe me rëndësi të veçantë, në zbatim të kërkesave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, është ai me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, konkretisht me IEVP Vlorë, Shërbimin e Provës dhe Zyrën e Përmbaramit, ku marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ka qënë i mirë .

Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, si hartimi i letërporosive, njohje vendimi të huaj, ekzekutim i letërporosive, ekstradime etj, ka pasur bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar duke ndikuar ndjeshëm në çështjet që lidhen me trafiket e paligjshme, dhe konkretisht me autoritetet gjyqësore italiane, greke, etj. Rezulton se të gjitha kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtar janë përcjellë përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe nuk evidentohet ndonjë rast kur kërkesa është drejtuar drejtpërdrejtë pranë organit gjyqësor kompetent të shtetit që i drejtohet kjo kërkesë e posaçërisht Republikës së Italisë, me të cilën shteti shqiptar ka nënshkruar edhe

marrëveshjen përkatëse. Konstatohet një korrektësi maksimale në raport me autoritet gjyqësore të huaja në përmbushje e detyrimeve ligjore, në një kohë kur pritet që edhe autoritete e huaja gjyqësore të na përgjigjen të njëjtën shkallë korrektësie.

Marrëdhëniet me median dhe publikun

Për vitin 2021 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është caktuar një prokuror si koordinator për marrëdhëniet me median dhe publikun.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, duke pasur në vëmendje të saj analizën vjetore, arritjet dhe nevojën për përmirësim, shtrirjen dhe përhapjen e kriminalitetit, grup veprat penale më shqetësuese aktualisht ka përcaktuar prioritetet për vitin në vazhdim:

- Rritja e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj veprave penale me tendencë në rritje të kriminalitetit, veçanërisht e veprave penale në fushën e narkotikëve dhe trafikimit të tyre.
- Konsolidimin e luftës kundër krimit ekonomik dhe financiar në vijim të punës së kryer nga njësia e përbashkët hetimore (seksioni i krimit ekonomik e financiar).
- Rritjen e numrit të hetimeve pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale.
- Bashkëpunimi më i lartë me strukturat e policisë për krimet e rënda si dhe kontrollet e veprimtarisë së policisë gjyqësore.
- Vëmendje e veçantë ndaj grupeve vulnerabël. Prokuroria do të vazhdojë të ndjekë një politikë penale të përshtatshme ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, apo edhe ndaj personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në aplikimin e dënimeve alternative
- Forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me të gjitha institucionet që kanë shërbime të policisë gjyqësore dhe koordinimi me institucione të tjera ligj zbatuese si domosdoshmëri në punën e organit të prokurorisë.
- Forcimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe bashkëpunimit me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit.
- Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambienteve të punës për prokurorët mbetet një objektiv i rëndësishëm edhe për vitin 2022.

Në vazhdim të punës tonë dhe arritjeve Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë synon të përmirësojë në vijim hetimin e ndjekjes penale, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimin e kushtetutës dhe ligjeve në fuqi duke treguar profesionalizëm dhe sjellje etike.